



## **EULEX: Ende në kërkim të identitetit**

Raport përcjellës mbi vlerësimin e punës së EULEX-it

09/04/2010  
Prishtinë, Kosovë

## **Përmbledhje ekzekutive**

EULEX-i vazhdon të ketë problem me imazhin e tij. Qëllimet e zbardhimit të këtij misioni në Kosovë ishin sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe krimet të organizuar. Por, pavarësisht entuziazmit të treguar në fillim dhe pritjeve të mëdha shumë pak arritje ka në këtë drejtim. Kosova është paraqitur dhe paraqitet si vend me nivel të lartë të korrupsionit në raporte ndërkombëtare vazhdimisht. Mungesa e arritjeve në luftën kundër korrupsionit po ndikon në rrënjëzimin e mëtejshëm të tij në institucionet Kosovare.

EULEX-i, ka dalë me deklarata se do të ketë arrestime të zyrtarëve të lartë për korrupsion por kjo gjë nuk ka ndodhur. Kjo ka ndikuar që pritjet e qytetarëve të rriten dhe të zhgënjehen përsëri. Zhgënjimi i këtyre pritjeve u pa edhe me reagimin e disa organizatave të shoqërisë civile kundër gjendjes së sundimit të ligjit në Kosovë duke shprehur pakënaqësinë me punën e EULEX-it. Kënaqësia me punën e EULEX-it mes qytetarëve ka rënë po ashtu.

Çështja e reformës së gjyqësorit nuk është marrë me seriozitet deri më tani. Fatkeqësisht, nuk vërehet ndonjë vullnet politik të asnjë nga aktorët e përfshirë për të shpejtuar reformat në gjyqësor. Tashmë, është bërë urgjente nevoja e aprovimit të ligjit për gjykatat, ristrukturimi i gjykatave dhe përfundimi i procesit të riemërimit. Një problem shumë i madh mbetet numri i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, në krahasim me numrin e policëve.

Gjykatat në veri që u mbyllën në vitin 2008, ende nuk janë funksionalizuar plotësisht. Tani kjo gjykatë funksionon vetëm me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë. Sidoqoftë, aktiviteti i Z. Kermabo në Beograd dhe Prishtinë është një hap në drejtimin e duhur për të zgjidhur problemin e sundimit të ligjit në veri.

Pikat doganore 1 dhe 31 ende nuk janë funksionale. Aktualisht këto pika janë duke funksionuar me zyrtarë të EULEX-it që vetëm bëjnë regjistrimin e hyrjes dhe daljes së mallrave, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit doganor. Në këtë drejtim EULEX-i prapë është i kufizuar në operim duke pritur një marrëveshje politike mes Prishtinës dhe Beogradit. EULEX nuk është duke doganuar mallrat fare në pikat 1 dhe 31, për shkak se nuk dihet se ku duhet të shkojnë paratë e mbledhura. Kjo është status quo-ja në veri tash sa i përket doganave dhe duket se nuk do të ndryshojë së shpejti.

## **Përmbajtja**

Përmbledhje ekzekutive.....	2
Hyrje.....	4
Rekomandimet për Qeverinë dhe EULEX-in.....	6
Rekomandimet për BE dhe PSBE.....	12

## Hyrje

EULEX-i vazhdon të ketë problem me imazhin e tij. Qëllimi i zbardhimit të këtij misioni në Kosovë ishin sundimit i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe krimet të organizuar. Por, pavarësisht entuziazmit të treguar në fillim dhe pritjeve të mëdha shumë pak arritje ka në këtë drejtim. Kosova është paraqitur dhe paraqitet si vend me nivel të lartë të korrupsionit në raporte ndërkombëtare vazhdimisht, siç është raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit.

EULEX-i, përkatësisht kryeprokurori i EULEX-it ka dalë me deklarata se në këtë pranverë do të ketë arrestime të zyrtarëve të lartë për korrupsion<sup>1</sup> por kjo gjë nuk ka ndodhur. Kjo ka ndikuar që pritjet e qytetarëve të rriten dhe të zhgënjehen përsëri. Zhgënjimi i këtyre pritjeve u pa edhe me reagimin e disa organizatave të shoqërisë civile kundër gjendjes së sundimit të ligjit në Kosovë duke shprehur pakënaqësinë me punën e EULEX-it. Kënaqësia me punën e EULEX-it mes qytetarëve ka rënë po ashtu, sipas raportit të paralajmërimit të hershëm nr. 27 të UNDP-së. Mungesa e sukseseve në luftën kundër korrupsionit po ndihmon në përhapjen e mëtutjeshme të tij edhe në institucione që kanë qenë relativisht më pak të prekura nga ai, siç është Policia e Kosovës.<sup>2</sup>

Më 27 Dhjetor Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL) publikoi raportin vlerësues për punën një vjeçare të EULEX-it “EULEX: Duke kërkuar identitetin”. Raporti ndahet në disa pjesë, pjesa e parë kryesisht ka të bëjë me misionin e EULEX në Kosovë, qëllimet e këtij misioni dhe sferat në të cilat ky mision është përqendruar. Raporti vazhdon me një pjesë të veçantë e cila i kushtohet arritjeve që ka pasur EULEX në Kosovë, në dogana, polici dhe gjyqësi. Një pjesë i kushtohet perceptimeve të qytetarëve për EULEX-in. Një kapitull i kushtohet dështimeve të këtij misioni dhe mospërmbushjes së qëllimeve për të cilat është prezent në Kosovë. Raporti përfundon me një listë të rekomandimeve për EULEX-in, Qeverinë e Kosovës, BE-në dhe Përfaqësuesin Special të BE-së (PSBE).

Rekomandimet tona në këtë raport ishin:

Për Qeverinë dhe EULEX-in

Të shfrytëzohet më mirë Bordi i Sundimit të Ligjit duke shërbyer si forum ku krijohet një listë e caqeve që duhet të arrihen brenda një viti.

---

<sup>1</sup> SE Times. EULEX heton korrupsionin e nivelit të lartë në Kosovë. 04 nëntor 2009.

<sup>2</sup> Takim me përfaqësues të sektorit privat, 25 Mars 2010 dhe 01 Prill 2010.

- Të harmonizohen strategjitë mes EULEX-it dhe ministrive që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit.
- Të përmirësohet koordinimi i brendshëm i EULEX-it.
- T'i kushtohet vëmendje të veçantë reformës së gjyqësorit meqenëse është hallka kryesore e sundimit të ligjit.
- Të ndërmerren hapa të menjëhershëm për funksionalizimin e plotë të gjykatës në veri të Mitrovicës brenda tre muajve.
- Të funksionalizohen plotësisht pikat doganore 1 dhe 31 sa më shpejtë që është e mundur.
- Të bëhet transparent brenda mundësive shqyrtimi i rastit Bllaca.
- Të rritet sensi i misionit brenda stafit të EULEX-it për të parandaluar shndërrimin në një mision që i shërben vetvetes.
- Të identifikohen fushat ku EULEX-i mund të ndihmojë në plotësimin e kriterëve për liberalizim të vizave.

#### Për BE-në dhe PSBE-në

- Të krijohet presion mbi udhëheqësinë kosovare për reformat e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit me fokus te gjyqësori.
- Të krijohet presion mbi Beogradin për të mos penguar funksionalizimin e pikave doganore 1 dhe 31 dhe gjykatës në Mitrovicë veriore.
- Të forcohet udhëheqësia që i ofrohet misionëve të BE-së në Kosovë.
- Të shfrytëzohen fuqitë e reja të dala nga traktati i Lisbonës për Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për të lehtësuar funksionimin e misionëve të BE-së në Kosovë.
- Të forcohet udhëheqësia politike e PSBE-së, dhe ku është e nevojshme të bëhet presion për tu krijuar vullneti politik për reforma.

Kjo analizë ka për qëllim që të rishikojë punën e EULEX-it pas publikimit të këtij raporti. Përkundrazi kjo analizë do të ketë rekomandimet që janë bërë për EULEX-in, Qeverinë e Kosovës, BE-në dhe Përfaqësuesin Special të BE-së (PSBE). Pra, synimi është të bëjmë vlerësimin e punës së këtyre institucioneve duke u bazuar në këto rekomandime. Qëllimi kryesor i kësaj analize është të shihet nëse është bërë ndryshim në lidhje me këto rekomandime. Të shihet se a ka ndryshuar gjendja që nga publikimi i raportit. Më poshtë është rishikimi i rekomandimeve.

## **Rekomandimet për Qeverinë dhe EULEX-in**

**Të shfrytëzohet më mirë Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit duke shërbyer si forum ku krijohet një listë e caqeve që duhet të arrihen brenda një viti**

Bordi i Sundimit të Ligjit ka vazhduar të takohet si përpara. Mirëpo, ende nuk ka ndonjë dokument publik të këtij bordi që tregon se ekziston një strategji e përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-it për përmirësimin e sundimit të ligjit. Megjithatë, bashkë-kryesuesit e këtij bordi, Zëvendëskryeministri Kuçi dhe Shefi i EULEX-it, Kermabo kanë theksuar nevojën për të luftuar korrupsionin.

Në takimin e fundit si prioritete u caktuan sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik dhe perspektiva e integritetit evropian. Po ashtu u theksua se prioritete mund të arrihen më mirë me veprime konkrete të qeverisë së Kosovës dhe EULEX-it. Por, deri më tani nuk ka ndonjë plan konkret për veprimet që do të ndërmerren në lidhje me këto prioritete të deklaruara. Kurse lidhur me përmbushjen e kritereve teknike për liberalizimin e vizave u kërkua angazhim shtesë të EULEX-it në këtë drejtim.<sup>3</sup>

Ndryshimet e fundit në qeveri, ku janë ndërruar dy ministra anëtarë të këtij bordi, ai i Punëve të Brendshme dhe ministrja e Drejtësisë, mund të ndikojnë në efikasitetin e tij.<sup>4</sup>

**Të harmonizohen strategjitë mes EULEX-it dhe ministrive që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit**

Edhe pse vazhdimisht është përmendur nevoja e forcimit të bashkëpunimit mes Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-in, kjo ka hasur në vështirësi në praktikë.

Përderisa EULEX-i ka shprehur mbështetje për Qeverinë e Kosovës duke deklaruar haptas se do të ndihmojë në sundimin e ligjit në Kosovë, ka pasur edhe fërkime mes tyre. Në anën tjetër, kur Kosova u kritikua nga Departamenti Amerikan i Shtetit për nivelin e korrupsionit, EULEX-i e ndjeu të nevojshme të theksojë se përgjegjësia për këtë është te institucionet kosovare.<sup>5</sup> Pas kësaj

---

<sup>3</sup> Koordinimi i Sundimit të Ligjit (<http://www.eulexkosovo.biz/alb/index.php?id=8&n=181>)

<sup>4</sup> Takim me përfaqësues të Qeverisë, 08 Prill 2010.

<sup>5</sup> EULEX-i ia lë Qeverisë luftimin e korrupsionit. Koha Ditore. 22 Mars 2010.

Qeveria e Kosovës krijoi një "task forcë" për luftë kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK), në koordinim të plotë edhe me EULEX-in dhe institucionet tjera<sup>6</sup>. Kjo u mirëprit nga EULEX-i, i cili ofroi mbështetje për këtë "task forcë".<sup>7</sup> Në të njëjtën kohë, ishim dëshmitarë të një lufte fjalësh mes zyrtarëve të lartë të qeverisë dhe atyre ndërkombëtare lidhje me arrestime të pjesëtarëve të qeverisë për korrupsion.<sup>8</sup>

Rasti i strategjisë së supozuar për veriun është një shembull i mungesës së koordinimit të mirëfilltë mes qeverisë, EULEX-it dhe organizatave tjera ndërkombëtare. Siç duket, ky dokument është përpiluar kryesisht nga organizatat ndërkombëtare, por u përfol në publik si dokument i Qeverisë dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN, ang. ICO). EULEX, ishte shumë i shpejtë të deklarojë se nuk ka të bëjë asgjë me këtë strategji, edhe pse sipas EULEX-it ka nevojë urgjente për përmirësimin e gjendjes së sundimit të ligjit në veri të Kosovës.<sup>9</sup> Më vonë, Qeveria mori iniciativën duke caktuar një koordinator të "Strategjisë për veriun" dhe kjo mbeti në pronësi të Qeverisë dhe ICO-së, edhe pse përmban aktivitete të parapara të EULEX-it në veri. Tash jemi në një situatë kur ekziston një koordinator i një "Strategjie" që nuk është publikuar kurrë, dhe e cila mohohet nga akterë kryesorë të implementimit eventual të saj.

Paralelisht, Bashkimi Europian ka hapur një zyrë – "Shtëpia e BE-së" – me synimin që të shtendosë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Misioni do të drejtohet nga ambasadori italian në Prishtinë, Michael Giffoni, i cili u emërua si "facilitator" i BE-së për veriun. Ai do të bashkëpunojë edhe me EULEX-in dhe Komisionin Evropian. (Natyrisht, këtu nuk do të përfshihet Zyra Civile Ndërkombëtare).

**T'i kushtohet vëmendje të veçantë reformës së gjyqësorit meqenëse është hallka kryesore e sundimit të ligjit**

---

<sup>6</sup> Departament të veçantë antikorrupsion. Zëri. 26 Shkurt 2010.

<sup>7</sup> Shefi i misionit EULEX, Yves de Kermabon, e mirëpret themelimin e Task Forcës Anti-Korrupsion nga Qeveria e Kosovës (<http://www.eulex-kosovo.eu/alb/?id=8&n=197>).

<sup>8</sup> Kuçi EULEX-it: Nëse keni dëshmi për korrupsion, veproni. Koha Ditore. 19 mars 2010.

<sup>9</sup> Strategjia pa KFOR e EULEX. Zëri. 26 Shkurt 2010.

Reformimi i gjyqësorit dhe sundimi i ligjit janë radhitur si prioritete nga Qeveria e Kosovës dhe EULEX-i. Megjithatë, çështja e reformës së gjyqësorit nuk është marrë me seriozitet. EULEX nuk ka pasur rol aktiv në procesin e riemërimit të gjyqtarëve, kështu duke humbur mundësinë e monitorimit me të përafërt të një procesi shumë të rëndësishëm.

Po ashtu, EULEX nuk ka bërë ndonjë presion publik te qeveria e Kosovës për t'i shpejtuar reformat në gjyqësor. Raporti i progresit i BE-së i vitit 2009 për Kosovën thekson se Kosova ende duhet t'i adoptojë katër ligje të reformës: për gjykatat, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për Prokurorinë, dhe për Këshillin prokurorial. Fatkeqësisht, nuk vërehet ndonjë vullnet politik te asnjë nga aktorët e përfshirë për të shpejtuar reformat në gjyqësor. Tashmë, është bërë urgjente nevoja e aprovimit të ligjit për gjykatat, ristrukturimi i gjykatave dhe përfundimi i procesit të riemërimit.

Një problem shumë i madh mbetet numri i vogël i gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it, në krahasim me numrin e policëve. Numri i pozitave të hapura për komponentin e gjyqësorisë është 59 (në kuadër të tyre gjyqtarë, prokuror, punonjës logjistike), që është shumë i lartë.<sup>10</sup> Nga 50 gjyqtarë të paraparë, vetëm 31 janë në punë, si dhe nga 35 pozita të prokurorëve të parapara, vetëm 15 janë të plotësuar.<sup>11</sup>

Një problem tjetër është se nuk ka ndarje mes gjyqtarëve që duhet të merren me monitorim, mentorim dhe këshillim dhe atyre që kanë kompetenca ekzekutive. Kështu që gjyqtarët e EULEX-it janë të detyruar edhe të kryejnë gjykime edhe të merren me mbikëqyrjen e kolegëve të tyre vendorë. Po ashtu, përderisa në komponentin e policisë, EULEX ka një plan mjaftë të qartë të monitorimit,

---

<sup>10</sup> Në sektorin e policisë kërkohen gjithsej 233 punonjës, duke përfshirë këtu edhe stafin për zyret operacionale dhe për krime lufte. Në sektorin e doganave janë 13 pozita pune të hapura. Shih: EULEX KOSOVO- Eleventh Call for Contributions (<http://www.eulex-kosovo.eu/vacancies/docs/11th/Annex-I-Job-descriptions-EULEX-Kosovo-11th-CfC.pdf>) (Së fundi është kontrolluar më 08/04/2010).

<sup>11</sup> Takim me EULEX, 16 Shkurt 2010.

mentorimit dhe këshillimit dhe hapave që duhet të ndërmerren për përmirësim, diçka e tillë nuk ekziston për komponentin e gjyqësisë dhe doganave.<sup>12</sup>

Sa i përket kompetencave ekzekutive në lidhje me rastet që trajton EULEX (deri në Mars 2010), janë dhënë 63 verdikte nga gjyqtarët e EULEX-it (516 dëgjime), ndërsa Prokurorët e EULEX-it janë në krye të 1073 rasteve (deri në Janari 2010). Më hollësisht, sa i përket krimit të organizuar, (nga 16 qershor 2009 deri më 31 dhjetor 2009) Seksioni i Krimit të Organizuar të Prokurorisë Speciale (PSRK) është marrë me 45 raste. Ka një rritje prej 10 rasteve të reja në këtë seksion. Nga 45 raste, 42 janë raste aktive. 33 raste të krimit të organizuar janë në një fazë paragjyqësore, 3 raste janë në një fazë të gjykimit kryesor dhe 3 verdikte janë dhënë në rastet e krimit të organizuar. Ndërsa, gjyqtarët e EULEX-it e kanë dhënë verdikte në 4 raste të lidhura me korrupsionin.<sup>13</sup>

### **Të ndërmerren hapa të menjëhershëm për funksionalizimin e plotë të gjykatës në veri të Mitrovicës brenda tre muajve**

Gjykatat në veri që u mbyllën në vitin 2008, ende nuk janë funksionalizuar plotësisht. Në mars të këtij viti EULEX-i propozoi që të fillon punën Gjykata e Qarkut në veri të Mitrovicës. EULEX-i propozoi që gjykata të fillon punën me 6 gjyqtarë, prej tyre dy shqiptarë, dy të komunitetit serb dhe dy ndërkombëtarë. Propozimi për rifillimin e punës në Gjykatat në veri, ka hasur në sfida sepse zyrtarët kosovarë kanë shfaqur kundërshtim të përfshirjes së gjyqtarëve serbë kanë qenë të nominuar nga Beogradi dhe dhënë betimin në Serbi para presidentit Tadic.<sup>14</sup>Tani kjo gjykatë funksionon vetëm me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë.

Sipas EULEX-it, Prishtinës dhe Beogradit i takon të merren me çështjen e Mitrovicës dhe veriut të Kosovës dhe këtë duhet ta zgjidhin me bisedime.<sup>15</sup> Mirëpo, një zgjidhje politike nuk duket e afërt. Sidoqoftë, vizita e Z. Kermabo në

---

<sup>12</sup> Takim me zyrtar të EULEX, 29 Mars 2010.

<sup>13</sup> Takim me zyrtar të EULEX, 25 Mars 2010.

<sup>14</sup> EULEX propozon rihapjen e gjykatave në veri. Zëri. 25 Mars 2010.

<sup>15</sup> EULEX-i rithekson mosndërrhyrje në vendime politike . BBC Shqip.

([http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2010/04/100403\\_arber-intv.shtml](http://www.bbc.co.uk/albanian/news/2010/04/100403_arber-intv.shtml)) (03/04/2010).

Beograd është një hap në drejtimin e duhur për të zgjidhur problemin e sundimit të ligjit në veri.

### **Të funksionalizohen plotësisht pikat doganore 1 dhe 31 sa më shpejtë që është e mundur**

Zyrtarët e EULEX-it janë shprehur se qëllimi i tyre është që të rikthejnë doganierët e Doganës së Kosovës dhe të vendosin kontrollin e plotë në pikat doganore të cilat janë djegur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Por janë dy çështje që duhen zgjidhur: ajo se cili ligj duhet të zbatohet dhe si duhet të shpërndahen të hyrat doganore. Aktualisht këto pika janë duke funksionuar me zyrtarë të EULEX-it që vetëm bëjnë regjistrimin e hyrjes dhe daljes së mallrave, të cilat nuk i nënshtrohen kontrollit doganor. Në këtë drejtim EULEX-i prapë është i kufizuar në operim duke pritur një marrëveshje politike mes Prishtinës dhe Beogradit.<sup>16</sup> EULEX nuk është duke doganuar mallrat fare në pikat 1 dhe 31, për shkak se nuk dihet se ku duhet të shkojnë paratë e mbledhura. Kjo është status quo-ja në veri tash sa i përket doganave dhe duket se nuk do të ndryshojë së shpejti. Megjithatë, mungesa e doganimit nuk mund të vazhdojë dhe duhet të gjendet një zgjidhje teknike për deponimin/shfrytëzimin e të hyrave në këto pika pa pasur nevojë të pritet një zgjidhje politike situatës.

### **Të bëhet transparent brenda mundësive shqyrtimi i rastit Bllaca.**

Rasti Bllaca ishte rasti i cili vuri në pah mos efikasitetin e gjyqësisë së EULEX-it. Megjithatë pas daljes publike të Nazim Bllacës me deklaratat e tij, dhe pas presionit publik të medieve në dhjetor u dha urdhri për arrest shtëpiak të tij,<sup>17</sup> Sidoqoftë, ky rast mbeti i rrethuar me mistere.

Pas kësaj janë bërë edhe disa arrestime në lidhje me këtë rast, pra arrestimi i Driton H. i cili akuzohet për pjesëmarrje në dy tentim vrasje, njëra e kryer në nëntor 1999 në Prishtinë, kurse e dyta në qershor 2000 në Ferizaj.<sup>18</sup> Më pas u bë arrestimi i personit të tretë, Shpresim Uka. Pa u dhënë asnjë detaj në lidhje me arrestimin dhe rastin, pas seancës dëgjimore ai u lirua, duke u obliguar që të paraqitet në gjykatë një herë në muaj. Detaje në lidhje me rastin Bllaca dhe

---

<sup>16</sup> Hyseni, Violeta. Ende pa zgjidhje për kontrollin doganor në veri. BBC Prishtinë. 23 Shkurt 2010

<sup>17</sup> EULEX. Deklaratë për shtyp: Nazim Bllaca në arrest shtëpiak (<http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?id=8&n=165>) (01/12/2009)

<sup>18</sup> EULEX. Arrestohet një person lidhur me rastin Bllaca (<http://www.eulex-kosovo.eu/alb/index.php?id=8&n=180>) (12/01/2010)

hetimet që po bën prokuroria dhe gjykata e EULEX-it për këtë rast nuk janë bërë të ditura asnjëherë.<sup>19</sup> Ky rast vazhdon të jetë i fortë në imagjinatën kolektive të publikut dhe mbetet test për EULEX-in.

**Të identifikohen fushat ku EULEX-i mund të ndihmojë në plotësimin e kriterëve për liberalizim të vizave.**

Sa i përket liberalizimit të vizave, disa nga fushat e veprimit në kuadër të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit fusha ku ndikohet drejtpërdrejtë në plotësimin e kushteve të liberalizimit të vizave.

---

<sup>19</sup> Bajrami, Selviqe. Lirohet Shpresim Uka. Zëri. 5 Mars 2010.

## **Rekomandimet për BE dhe PSBE**

### **Të krijohet presion mbi udhëheqësinë kosovare për reformat e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit me fokus te gjyqësori**

Disa vizita të profilit të lartë janë bërë në Kosovë në këtë kohë. Në takimin e fundit që pati Baronesha Ashton, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Siguri dhe nënpresidente e Komisionit Evropian tha premtoi mbështetje në rrugën e Kosovës drejt Unionit Evropian, duke premtuar edhe ekip për të vlerësuar punën që është bërë për liberalizimin e vizave. Ajo theksoi se me rëndësi të veçantë është edhe sundimit i ligjit në Kosovë.<sup>20</sup>

Edhe vizitat e Ministrit të Jashtëm të Francës, Z. Kushner, dhe Komisionerit për Zgjerim, Z. Fule kanë theksuar nevojën për përmirësimin e sundimit të ligjit. Sidoqoftë, komuniteti ndërkombëtarë duket i ndarë sa i përket presionit për ndryshime rrënjësore dhe deri tash nuk ka arritur të ndikojë te udhëheqësia kosovare për të shpejtuar reformat.

### **Të krijohet presion mbi Beogradin për të mos penguar funksionalizimin e pikave doganore 1 dhe 31 dhe gjykatës në Mitrovicë veriore.**

Ka pasur një presion relativisht më të madh ndaj Beogradit dhe Prishtinës për bashkëpunim rajonal dhe dialog. Për shembull, ministri i punëve të jashtme të Francës Bernard Kushner në takimin e tij me zyrtarët në Beograd vuri në pah çështjen e bashkëpunimit në mes vendeve Ballkanike, sidomos të bashkëpunimit dhe dialogut në mes të Serbisë dhe Kosovës. Në anën tjetër në Prishtinë pati takime të shumta ku përveç thirrjeve për mirëkuptim rajonal edhe dha mbështetjen për rrugën e Kosovës drejt Unionit Evropian.<sup>21</sup>

### **Të forcohet udhëheqësia që i ofrohet misionëve të BE-së në Kosovë**

---

<sup>20</sup> Komisioni Evropian. Catherine Ashton vizitoi Kosovën (<http://www.delprn.ec.europa.eu/?cid=1,103,756>) (08/04/2010).

<sup>21</sup> Oevertia franceze. Vizita e Kushner në Serbi dhe Kosovë (28 Shkurt deri 2 Mars, 2010). ([http://www.diplomatie.gouv.fr/en/country-files\\_156/serbia\\_362/visits\\_2680/bernard-kouchner-visit-to-serbia-and-kosovo-28.02-02.03.10\\_13803.html](http://www.diplomatie.gouv.fr/en/country-files_156/serbia_362/visits_2680/bernard-kouchner-visit-to-serbia-and-kosovo-28.02-02.03.10_13803.html)) (08/04/2010).

Përderisa misionet ndërkombëtare në Kosovë janë mjaftë të paqartë në ndarjen e kompetencave dhe fushave të veprimit, u mungon edhe udhëheqësia nga lartë. Secili përfaqësues premton vazhdimisht për mbështetje në rrugën e Kosovës drejt Unionit Evropian por në anën tjetër ka shumë pak konkrete që do ti mbështeste këto fjalë në realitet sa i përket udhëheqësisë që ofrohet për misionet këtu. Rasti i pikave doganore në veri është shembull i mungesës së përkushtimit. EULEX ka punësuar personel që nuk janë në gjendje të kryejnë punët e tyre si doganierë. Dhe lejimi i vazhimit të status quo-së është kundër përkushtimit verbal për përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

**Të shfrytëzohen fuqitë e reja të dala nga traktati i Lisbonës për Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për të lehtësuar funksionimin e misioneve të BE-së në Kosovë.**

Baronesha Ashton, duhet të përdorë të drejtën për iniciativë që të shtyjë proceset përpara për të gjetur zgjidhje teknike të problemeve pa pasur nevojë të pritët për zgjidhje politike që mund të mos vijë shpejt.

**Të forcohet udhëheqësia politike e PSBE-së, dhe ku është e nevojshme të bëhet presion për tu krijuar vullneti politik për reforma.**

Ka pasur diskutime rreth relacionit mes PSBE-së dhe Shefit të Misionit të EULEX-it. Nëse marrëdhënia mes tyre nuk është profesionale dhe kolegjiale, puna e misioneve do të vështirësohet. Dhe kjo duhet të kihet parasysh në përzgjedhjen e shefave të rinj të misioneve të BE-së në Kosovë. Deri më tash presioni i PSBE-së për reforma ka qenë i pakët dhe ka ardhur në formë të sugjerimeve për ndërrime të zyrtarëve të lartë të përmendur për korrupsion. Kjo në fakt mund të jetë kundër produktive, duke çuar në konflikt me liderë vendorë, sidomos kur kihet parasysh ndarja në mes të komunitetit ndërkombëtar sa i përket presionit për reforma.

## **RRETH NESH**

Instituti Ballkanik i Politikave është një institut i pavarur dhe jo-fitimprurës që synon të iniciojë dhe thellojë debatin rreth politikave publike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Me seli në Prishtinë, Kosovë, Instituti Ballkanik i Politikave punon për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë nëpërmjet bërjes së politikave pragmatike që punojnë për të mirën e qytetarëve.

Misioni ynë është forcimi i kuptimit e ndikimit që kanë politikat publike në mesin e qytetarëve të Kosovës, shoqërisë civile grupeve avokuese dhe institucioneve vendimmarrëse. Ne e bëjmë këtë duke identifikuar çështjet më thelbësore, duke bërë hulumtime, duke krijuar zgjidhje dhe strategji inovative që kanë për qëllim të kuptuarit dhe zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe politikave publike. Instituti Ballkanik i Politikave – IPOL ka për qëllim që të ofrojë analiza të shëndosha dhe profesionale për vendimmarrësit; të ofrojë metoda efektive për avokim për qytetarët dhe grupet e interesit duke i mbështetur ata në procesin e vendimmarrjes.

Objektivat e Institutit Ballkanik për Politika janë: Të sigurojë që proceset e integrimi evropiane, decentralizimit dhe reformës së tregut të jenë shfrytëzuar për forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim marrje; për ti fuqizuar komunitetet lokale për adresimin e sfidave të tyre në mënyrë të qëndrueshme; për të sjellë mirëqenie për qytetarët; për të rritur llogaridhënien e qeverisë dhe për të siguruar një ambient më të sigurt dhe më të shëndetshëm.

Instituti Ballkanik i Politikave bashkëpunon ngushtë me partnerë të shoqërisë civile, qeverisë dhe akademikë duke shfrytëzuar një qasje gjithëpërfshirëse drejt arritjes së qëllimeve; në mënyrë pro-aktive angazhohet me akterët kyç të hartuesve të politikave publike; në vazhdimësi zhvillon studime duke ofruar përgjigje të përshtatshme për çështje me rëndësi, bënë monitorimin e zbatimit të politikave publike duke analizuar edhe pasojat që krijojnë ato.

Fokusi i Institutit Ballkanik të Politikave përfshinë qeverisjen, zhvillimin e qëndrueshëm, çështjet sociale, shëndetësinë, arsimin, zhvillimin ekonomik, qeverisjen lokale, marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare, sundimin e ligjit, transparencën dhe shoqërinë civile. Institutit Ballkanik i Politikave punëson staf të përhershëm dhe ekspertë hulumtues të fushave të ndryshme, si dhe praktikantë. Stafi i Institutit dhe ekspertët janë individë të motivuar dhe dinamikë, të përkushtuar për Kosovën dhe rajonin e Evropës juglindore.